



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 715/ 15 prot.

Datë 28/05/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 577/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28/05/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 436/2024, datë 02.05.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF: 98934-03-20-2024, me objekt “Instalimet e sistemeve qëndrore të ngrohjes”, me fond limit 16.829.980 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK me NIPT: K71401004Ë dhe me adresë: Rruga “Adem Jashari”, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë  
Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”..

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 02.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 436/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Kevin Konstruktion" ShPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF: 98934-03-20-2024, me objekt "Instalimet e sistemeve qendrore të ngrohjes", me fond limit 16.829.980 leke, pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Kevin Konstruktion" ShPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresat nr. 1890 prot., datë 08.05.2024 dhe nr. 2043 prot, datë 15.05.2024, të protokolluara përkatësisht me tonat me nr. 715/10 prot., datë 09.05.2024 dhe nr. 715/12 prot, datë 17.05.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, informon si më poshtë vijon:

*"Gjatë periudhës së pritjes së Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike është depozituar Shkresa me Nr.14854 prot. datë 15.04.2024 protokolluar nga ana jonë me Nr.1597 datë 17.04.2024 me lëndë "Njoftim për ndryshim buxheti sipas V.K.B Nr.36, datë 28.03.2024", përmes të cilit institucionit tonë i janë akorduar shtesa fondesh për vitin 2024 në lidhje me investimet ekzistuese. Më konkretisht për zërin buxhetor me emërtim "Instalimet e sistemeve qendrore të ngrohjes" me (kod projekti 1012553) ka ardhur një shtesë fondi në vlerë 19.736.242 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet e dy) Leke me Tvsh. Pra kosto e plotë e këtij projekti bëhet 39.932.218 (tridhjetë e nënte milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) Lekë me Tvsh.*

*Përsa më sipër më datë 08.05.2024 ju kemi vënë në dijeni me anë të Shkreses Nr. 1890 prot. për nevojën e Autoritetit Kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit sepse kanë ndryshuar kushtet financiare për këtë zë buxhetor, duke ju garantuar zbatimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Nr. 715/8 prot. datë 02.05.2024 protokolluar pranë Institucionit tonë me Nt. 1864*

*datë 07.05.2024, gjatë përgatitjes së dokumentacionit për procedurën e re të prokurimit, kërkojmë bashkëpunimin tuaj.*

*Përveç arsyes së sipërcituar, për ngarkimin në SPE të Formularit të Njoftimit të Anullimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, lindi e nevojshme pezullimi i procedurës duke mos bërë asnjë ndryshim në afatet e zhvillimit të tenderit, duke e bërë të pamundur teknikisht që të zhvillohet më kjo procedurë prokurimi. Nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik është kërkuar domosdoshmëria e Lejimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik për vijimin e anullimit të procedurës së prokurimit.*

*Ju lutemi kërkojmë mbështetjen tuaj për anulimin e procedurës për të bërë të mundur publikimin rishtas të saj me ndryshimet e vendosura në Nr.715/8 prot. datë 02.05.2024 protokollar pranë Institucionit tonë me Nr. 1864 date 07.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Shkresën me Nr. 14854 prot. datë 15.04.2024 protokolluar nga ana jonë me Nr.1597 date 17.04.2024 me lëndë "Njoftim për ndryshim buxheti sipas V.K.B Nr.36, datë 28.03.2024".*

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresat nr. 1890 prot., datë 08.05.2024 dhe nr. 2043 prot, datë 15.05.2024, të protokolluara përkatësisht me tonat me nr. 715/10 prot., datë 09.05.2024 dhe nr. 715/12 prot, datë 17.05.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, informon si më poshtë vijon:

*“Gjatë periudhës së pritjes së Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike është depozituar Shkresa me Nr.14854 prot. datë 15.04.2024 protokolluar nga ana jonë me Nr.1597 datë 17.04.2024 me lëndë "Njoftim për ndryshim buxheti sipas V.K.B Nr.36, datë 28.03.2024", përmes të cilit institucionit tonë i janë akorduar shtesa fondesh për vitin 2024 në lidhje me investimet ekzistuese. Më konkretisht për zerin buxhetor me emërtim "Instalimet e sistemeve qendrore të ngrohjes" me (kod projekti 1012553) ka ardhur një shtesë fondi në vlerë 19.736.242 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet e dy) Leke me Tvsh. Pra kosto e plotë e këtij projekti bëhet 39.932.218 (tridhjetë e nënte milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) Lekë me Tvsh.*

*Përsa më sipër më datë 08.05.2024 ju kemi vënë në dijeni me anë të Shkreses Nr. 1890 prot. për nevojën e Autoritetit Kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit sepse kanë ndryshuar kushtet financiare për këtë zë buxhetor, duke ju garantuar zbatimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Nr. 715/8 prot. datë 02.05.2024 protokolluar pranë Institucionit tonë me Nt. 1864 datë 07.05.2024, gjatë përgatitjes së dokumentacionit për procedurën e re të prokurimit, kërkojmë bashkëpunimin tuaj.*

*Përveç arsyes së sipërcituar, për ngarkimin në SPE të Formularit të Njoftimit të Anullimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, lindi e nevojshme pezullimi i procedurës duke mos bërë asnjë ndryshim në afatet e zhvillimit të tenderit, duke e bërë të pamundur teknikisht që të zhvillohet më kjo procedurë prokurimi. Nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik është kërkuar*

*domosdoshmëria e Lejimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik për vijimin e anullimit të procedurës së prokurimit.*

*Ju lutemi kërkojmë mbështetjen tuaj për anulimin e procedurës për të bërë të mundur publikimin rishtas të saj me ndryshimet e vendosura në Nr.715/8 prot. datë 02.05.2024 protokollar pranë Institucionit tonë me Nr. 1864 date 07.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Shkresën me Nr. 14854 prot. datë 15.04.2024 protokolluar nga ana jonë me Nr.1597 date 17.04.2024 me lënde "Njoftim për ndryshim buxheti sipas V.K.B Nr.36, datë 28.03.2024".*

II.2. Referuar shkresave të mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor njofton se do të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e kësaj procedure prokurimi do të zbatojë të gjitha përcaktimet e vendimit nr. 436/2024, datë 02.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF: 98934-03-20-2024, me objekt “Instalimet e sistemeve qendrore të ngrohjes”, me fond limit 16.829.980 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor në rishpalljen e procedurës së prokurimit të reflektojë në dokumentat e tenderit përcaktimet e Vendimit nr. 436/2024, datë 02.05.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**KreshnikTernova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**